

VENDIM
Nr. 138, datë 6.3.2025

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË VENDIMIN NR. 305, DATË 22.5.2024, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA REALIZIMI I PROJEKTIT ‘ZGJERIMI I SEGMENTIT RRUGOR DALJE ELBASAN–PËRRENJAS–QAFËTHANË’”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, të ndryshuar, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministër i Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 305, datë 22.5.2024, të Këshillit të Ministrave, “Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit ‘Zgjerimi i segmentit rrugor dalje Elbasan–Përrenjas–Qafëthanë’”, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

a) Pikat 3 dhe 4 ndryshohen, si më poshtë vijon:

“3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, pronë private, që shpronësohen, kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse të kompensimit, që paraqitet në tabelën që i bashkëlidhet këtij vendimi, për pasuritë e llojit “arë”, “truall” dhe “ndërtesë”, me vlerë të përgjithshme shpronësimi prej 6 942 926.9 (gjashtë milionë e nëntëqind e dyzet e dy mijë e nëntëqind e njëzet e gjashtë pikë nëntë) lekësh.

4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, prej 6 942 926.9 (gjashtë milionë e nëntëqind e dyzet e dy mijë e nëntëqind e njëzet e gjashtë pikë nëntë) lekësh, përballohet, si më poshtë vijon:

a) 3 223 464 (tre milionë e dyqind e njëzet e tre mijë e katërqind e gjashtëdhjetë e katër) lekë, nga Autoriteti Rrugor Shqiptar;

b) 3 719 462.90 (tre milionë e shtatëqind e nëntëmbëdhjetë mijë e katërqind e gjashtëdhjetë e dy pikë nëntëdhjetë) lekë, nga buxheti i shtetit, llogaria “Fondi i shpronësimeve” në Bankën e Shqipërisë.”.

b) Tabelës, bashkëlidhur vendimit, i shtohet tabela që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Pronarët e pasurisë së paluajtshme, pronë private, të pasqyruar në tabelën shtesë, që i bashkëlidhet këtij vendimi, kompensohen, për efekt shpronësimi, pasi të kenë paraqitur dokumentacionin justifikues për likuidim pranë Agjencisë Shtetërore për Shpronësimin.

3. Agjencia Shtetërore për Shpronësimin kryen procedurat për likuidimin e pronarëve të shpronësuar, sipas përcaktimeve të bëra në këtë vendim.

4. Shpenzimet procedurale shtesë, në vlerën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë, përballohen nga Autoriteti Rrugor Shqiptar.

5. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Autoriteti Rrugor Shqiptar, Agjencia Shtetërore për Shpronësimin, Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Zyra Vendore Librazhd, dhe Drejtoria e Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës pranë Këshillit të Qarkut Elbasan për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku

LISTA EMËRORE SHITESË E PRONARËVE, PASURITË E PALUAJTSHME , PRONË PRIVATE E TË
CILËVE SHPRONËSOHEN PËR REALIZIMIN E PROJEKTTIT, ZGJERIMI I SEGMENTIT RRUGOR
DALJE ELBASAN–PËRRENJAS–QAFËTHANË”

Nr. rendor	PRONARI					Të dhënat kadastrale (sipas kartelës së pasurisë)				Vlerësimet për shpronësim, sipas llojit të pasurisë			Objekt	Vlera totale në lekë	Shënime (D+E) Kufizime hipotekare, barrë mbi pasurinë etj.
	Emri	Atësia	Mbiemri	Adresa e pasurisë	Rrethi	Zona Kadastrale	Nr. Pasurie	Lloji i pasurisë	Sipërfaqe totale	Sip. (m²)	Çmimi (lekë/m²)	Vlera (lekë)			
34	Ilir	Mustafa	Koçi	Miraka	Librazhd	2696	2192-N	Ndëncësi	124.2				3,719,462.90	3,719,462.90	Konfirmuar ASHK Librazhd
	Behare	Ali	Koci												
Vlera totale															

Vlerësimi për pasurinë e llojit “ndërtesë” është bërë me preventiv punimesh, bazuar në pikën 3 të vendimit nr. 138, datë 23.3.2000, të Këshillit të Ministrave, “Për kriteret teknike të vlerësimit dhe të përlogaritjes së masës së shpërblimit të pasurisë pronë private që shpronësohen, të pasurive që zhvlerësohen dhe të të drejtave të personave të tretë, për interes publik”, të ndryshuar.